



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 70, datë 17.03.2023

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË 14 FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË
QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË
TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË
THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”; Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”; VKM nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” i ndryshuar; Aktit normativ nr.8, datë 07.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019” si dhe sipas relacionit për gatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e listës së 14 familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura të pastreha si pasojë e shembjes së banesave të tyre, shkaktuar nga prishja e detyruar, sipas ekspertizave të thelluara, hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, sipas listës bashkëlidhur.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomike pranë Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 21.03.2023



Lista e familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë.

NR	Emër/Atësi/Mbiemri	Gjendja familjare	Rajoni nga vjen kërkesa
1	FATMIR XHEVIT SHEHU	2	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.1
2	SHEFQET ALI JANGOZI	2	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2
3	ELTON NIKOLL SPAHIU	3	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2
4	MAGDALENA DHIMITER PAPADHAMI	1	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2
5	LIRI ISLAM HOXHA	13	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2
6	STEFAN SOTIR THOMAJ	3	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2
7	BLERTA SOTIRAQ BUZO	5	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2
8	HERMAN GËZIM SKERA	5	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.3
9	FRAN NIKOLL SINONI	2	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.3
10	ARBEN ALUSH LIKJA	1	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5
11	SALI ISUF HIDRI	3	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5
12	JETMIR GJOVALIN KOVAÇAJ	5	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5
13	ALBERT SADIK KLLOGJRI	4	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5
14	SHABAN BASHKIM PELLUMBI	4	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5

Shënim : Përfundon me numër rendor 14 (katërbëdhjetë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 201/prot.
9

Durrës, më 27 03 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.70 datë 17.03.2023 “Për miratimin e listës së 14 familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë, të mbetura të pastreha, si pasojë e shembjes së banesave të tyre, shkaktuar nga prishja e detyruar, sipas ekspertizave të thelluara hartuar nga instuti i rindërtimit Tiranë.”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

